



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2020:067352

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05408721

E.nr.542/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi dhe sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në çështjen juridike përbarimore të kreditorit A.A. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Spitali i përgjithshëm Ferizaj, për pagesën e pagës jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, më datë 04.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përbarimore në lëndën **E.nr.542/23**, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.542/23, të datës 22.03.2023, e ka caktuar përbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit, kundër debitorit Spitali i përgjithshëm Ferizaj, për pagesën e pagës jubilarë dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.924/20, të datës 20.11.2020.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 15.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,969.74 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së, dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përbarimore në këtë çështje juridike përbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
E.nr.542/23, më datë 04.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi